

FJALA E DEPUTETIT NIKO PELESHI

E ENJTE 24 SHKURT 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Sot është një ditë e keqe për paqen dhe demokracinë në botë. Si ministër i Mbrojtjes, dua të them dy fjalë për situatën në Ukrainë dhe implikimet që ajo mund të ketë në zonën euroatlantike dhe veçanërisht në rajonin tonë të brishtë. Në orët e para të mëngjesit të sotëm, makineria ushtarake ruse, në vijim të një fabule cinike, të nisur prej kohësh, ka filluar ndërhyrjen luftarake në territorin sovran të Ukrainës. Raportohen humbje jete njerëzish të pafajshëm dhe dëme materiale. E dënojmë me forcë sulmin e pajustificuar dhe të paramenduar të Federatës Ruse ndaj sovranitetit dhe popullit ukrainas, si një akt që dënon rendin kushtetues botëror, çdo marrëveshje dhe ligj ndërkombëtar. Jemi më shumë se kurrë të bashkuar në NATO në këtë luftë vlerash, duke ndenjur vigjilentë dhe duke ndjekur çdo implikim apo sfidë të mundshme në rajonin tonë.

Shqipëria do të vazhdojë të japë kontributin e saj real ndaj Aleancës. E për sa i përket qëndrimit tonë të përbashkët, kur themi “Shqipëria”, nuk nënkuptojmë Partinë Socialiste apo qeverinë e Partisë Socialiste, nënkuptojmë politikën shqiptare, shoqërinë shqiptare, të gjithë shqiptarët të bashkuar, të paktën në çështje të mëdha të paqes e sigurisë në vendin tonë, por edhe në rajonin tonë. Ndaj dëshiroj të risjell në vëmendjen tuaj se kushdo, çdo shqiptar që është i interesuar për paqen dhe sigurinë në rajon, e natyrisht në Shqipëri, në Kosovë, e cila është në top të axhendës sonë, duhet të unifikohet në një qëndrim të përbashkët. Dëgjuam qëndrimin politik të ministres për Europën dhe Punët e Jashtme, që është qëndrimi i qeverisë shqiptare, është qëndrimi i Shqipërisë. Duhet të unifikohemi atje, nëse duam të flasim me një zë dinjitoz në këtë ditë të zezë për paqen dhe sigurinë. E të gjitha idetë për rezoluta, pse kaloi rezoluta ose nuk ka rezolutë, të gjithë e kuptojmë që nuk janë në dobi, nuk janë në të mirë të dinjitetit tonë, të pozicionit tonë në raport me aleatët apo me rajonin. Unë i kam ndjekur gjatë gjithë ditës, si cilido prej jush, qëndrimet e të gjitha qeverive, sidomos të vendeve anëtare të NATO-s dhe nuk shikoj rezoluta parlamentare. Jo se është një praktikë e padrejtë, e panjohur, por sot po flasim qeveritë në emër të vendeve të tyre, në emër të shoqërive të tyre dhe të popujve të Aleancës. Edhe ne kemi folur, kemi reaguar.

Siç e thashë, jemi më të bashkuar se kurrë në NATO. Populli thotë: “Çdo e keqe, e ka një të mirë” dhe agresioni rus ka provokuar të kundërtën e asaj çfarë mund të priste presidenti Putin, ka provokuar më shumë unitet, solidaritet, kohezion brenda vendeve të NATO-s. Të mos e prishim ne. Ndaj do t’ju lutesha të mos e përdorim edhe këtë çështje për axhenda politike, të mos reflektojmë edhe në këtë çështje ndasi politike apo ndasi brenda opozitës për të treguar se kush e ka zërin më të fortë, sepse kjo dëmton, në radhë të parë, rajonin, Kosovën, e më pak ne pastaj, që jemi pjesë e Aleancës dhe e kemi më të sigurt, natyrisht, të ardhmen dhe paqen e vendit tonë, madje, unë do të thosha edhe çështje të tjera, të cilat edhe pak më parë shtrëngohen dhe fryhen në një situatë, ku ne duhet të tregojmë që, si shqiptarë, dimë të jemi edhe përtej axhendave politike të ditës kur ka çështje më të mëdha. Këtu nuk e kam fjalën që të harrojmë çështjen, e cila u trajtua në komisionin hetimor parlamentar, ajo e impiantit të trajtimit të mbetjeve, të cilën do të thosha që nuk e shikoj negativisht, por në të kundërt, e shikoj këtë komision hetimor parlamentar si një zhvillim shumë pozitiv, si një standard të ri në frymën e reformimit të drejtësisë, sepse në memorien tonë ne kemi të gjithë raste

kur një parti, Partia Socialiste, ka këmbëngulur për të ngritur komisione hetimore parlamentare për muaj e muaj me radhë dhe i është mohuar e drejta, duke thënë: “Kjo çështje ka shkuar në prokurori dhe nuk mund të ngrihet një komision parlamentar”. Mund të përdorej kjo fabul, ndoshta mund të ketë edhe bazë kushtetuese, ligjore, dhe mendoj që po, por kjo rrugë nuk u zgjodh as nga njëra parti, as nga partia tjetër. Shkuam në një komision hetimor parlamentar, ku të gjithë ata që janë thirrur, kanë marrë pjesë me durim në respekt të komisionit, në respekt të mendimit të kundërt dhe ekstrem, dhe janë përgjigjur me orë të tëra deri te seanca më e gjatë, ajo me Kryeministrin. Le ta shohim të dyja palët, përtej përmbajtjes, ta shohim në formë si një standard të ri dhe shumë pozitiv. Së dyti, besoj që i gjithë ai diskutim i hapur, i bërë publik, nuk duhej t’i lërë shumë vend ekspertimit të rimarrjes së atyre temave në Kuvend.

Gjithkush është i lirë të shprehë mendimet e veta dhe ta përdorë këtë foltore edhe në funksion të axhendës politike, se, në fund të fundit, ky është sistemi: të konkurrojmë me mendime të ndryshme dhe synojmë që nëpërmjet komunikimit publik të fitojmë mbështetje, por jo të spekulojmë dhe jo të nëpërkëmbim kohën e çmuar të qytetarëve tanë, duke i mbajtur para ekranit për orë të tëra dhe pastaj, pa mjaftuar ai komision aq transparent, ta rimarrim gjatë gjithë ditës, në një ditë kaq të rëndësishme për çështje themelore të sigurisë dhe të paqes, atë tematikë duke e shtrembëruar. Unë nuk dua të bëj të njëjtin gabim dhe të merrem me ato tema. Mund të prek vetëm një a dy çështje, sepse të rëndësishme janë gjetjet e atij komisioni. E rëndësishme është që shqiptarët kuptuan se nuk bëhet fjalë (nuk po bëj politikë, po jap vetëm informacion teknik) për një abuzim, vjedhje të buxhetit të shtetit në 430 milionë euro, por bëhet fjalë për një investim nga buxheti i shtetit. Është shumë apo pak, as këtë nuk e marr përsipër ta vlerësoj, por që është shumë më pak sesa 430, pra është rreth 55 milionë euro investimi i deritanishëm i materializuar. Nuk po gjykoj asnjë procedurë. Nuk po mbajmë asnjë procedurë, ashtu siç kanë bërë të gjithë përfaqësuesit tanë të qeverisë në komisionin hetimor, ku kanë folur për qëllimin e mirë dhe për politikën mjedisore që e ka udhëhequr, le të themi, këtë procedurë dhe janë distancuar nga gjithçka mund të ketë aty brenda, që ne ia lëmë drejtësisë. Dhe këtu dua ta mbyll, duke thënë se ka një pyetje kardinale, së cilës duhet t’i përgjigjemi me shumë transparencë këtu në këtë Kuvend: cili është qëndrimi që ne duhet të mbajmë nga tani e në vazhdim me drejtësinë? Deri dje e kemi zëvendësuar drejtësinë këtu, në parlament, e kam thënë edhe herë tjetër, ndoshta në mënyrë të justifikuar, sepse nuk kemi pasur besim, nuk ka qenë kredibël sistemi i drejtësisë, i cili nuk jepte drejtësi, por e blinte dhe e shiste atë, pra i kemi zëvendësuar gjyqtarët dhe prokurorët me deputetë në këtë parlament.

Tani, reformën në drejtësi ne nuk po pretendojmë ta marrim vetë si meritë 100%, ndonëse reforma në drejtësi nuk filloi rastësisht, por filloi si një premtim elektoral dhe pastaj vazhdoi si program qeverie që në vitin 2013 nga Partia Socialiste. Ne nuk po e marrim vetë këtë meritë, por po themi që reformimin e sistemit të drejtësisë po e bëjmë së bashku. E kemi votuar, dhe kjo është një nga ngjarjet që do të na bëjë krenarë për shumë vite në historinë parlamentare shqiptare, me 100% të votave, të majtë e të djathtë, reformën në drejtësi. Tani, pyetja është: do t’i besojmë apo do ta intimidojmë? Në rast se një çështje është në SPAK, do të presim që SPAK-u të përgjigjet, apo do t’i bëjmë presion emocional, politik, intimidues SPAK-ut, duke thënë. Pra, ose do t’u besojmë, ose do të vazhdojmë me lojën e vjetër që ta zëvendësojmë ne drejtësinë këtu me propagandë politike. Komisioni e ka dhënë, është edhe një nga gjetjet e komisionit, dy kultura politike janë ballafaquar në atë komision: kultura politike e prezantuar nga Kryeministri dhe të gjithë ata që u përgjigjën në komision si dëshmitarë e distancimit nga çdo akt individual, i cili duhet të çmohet nga organet e drejtësisë dhe jo politikisht nga ne, si dhe kultura tjetër e Partisë Demokratike, e dy partive demokratike, të cilat vazhdojnë të zëvendësojnë e të japin vetë drejtësi apo padrejtësi duke zëvendësuar prokurorët, gjyqtarët dhe, së fundi, edhe policët. Kaq kisha, edhe në përgjigje të asaj çfarë u diskutua këtu. Ndërkohë, do të doja të prezantoja edhe një projektligj, por e shikoj që jam jashtë kohës. Nëse mund të them dy fjalë, zonja

Kryetare, që të mos e marr përsëri fjalën në pikën që vjen... (Ndërhyrje pa mikrofon) Po bëj një prezantim të projektligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Organizatën Hidrografike Ndërkombëtare". Më mirëkuptoni që po dal nga rendi, për të mos e marrë përsëri fjalën dhe për të vazhduar, nëse më lejoni, disa angazhime të tjera. Që prej vitit 1921, që është viti i themelimit të kësaj organizate, me akronimin IKH, ajo ka si mision të saj in lehtësimin e procedurave dhe sigurimin e informacionit hidrografik për mbarë botën, për qëllime lundrimi apo edhe qëllime të tjera, nëpërmjet bashkërendimit të punës me Shërbimin Hidrografik Kombëtar të vendit dhe të çdo vendi anëtar. Ajo çka përbën pjesën më të rëndësishme të këtij procesi janë përfitimet e Republikës së Shqipërisë, që do t'i sjellë anëtarësimi në IKO, pasi ato do të bëjnë të mundur ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore, ndikimin në sigurinë e ekonomisë detare, ndikimin në zhvillimin ekonomik, zhvillimin e marrëdhënieve shumëpalëshe me shtetet aleate të rajonit dhe më gjerë.

Natyrisht që ka një kosto tarifa që ne paguajmë, e cila është në bazë të anijeve detare me tonazh mbi 100 tonë, për Shqipërinë shkon rreth 8 mijë euro, por përfitimet ekonomike, përveç atyre që përmenda, janë më të mëdha sesa tarifa, qoftë përmes aksesit që ne marrim aty për të shitur, informacionet apo hartat që prodhohen, qoftë nga Shërbimi Hidrografik, qoftë edhe nga Instituti ynë i Gjeografisë apo shumë shërbime të tjera që ofron kjo organizatë, siç janë trajnimet, shkollimi i stafit e të tjera. Nuk po zgjatem më tepër. Natyrisht, kemi informacione më të detajuara, në rast se do të ketë interes nga deputetë dhe jam këtu për t'u përgjigjur. Faleminderit!